



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 232/2018
Datë: 30 maj 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 17 paragrafi 3 të Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 30 maj 2018, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Raporti i Komisionit për Transferim dhe Avancim të prokurorëve të shtetit, me listën e prokurorëve të propozuar për avancim, si më poshtë:
1. Znj. Sheribane Selimi Muçaj, prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, avancohet në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
 2. Z. Veton Shabani, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj;
 3. Z. Agim Kuka, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, avancohet në Departamenti për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Ferizaj;
 4. Znj. Fetije Bajrami, prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, avancohet në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë;
 5. Z. Naim Beka, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë;
 6. Z. Shqipdon Fazliu, prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Gjilan, avancohet në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
 7. Z. Agron Qalaj, prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, avancohet në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe
 8. Z. Idain Smailji, prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë së Apelit, avancohet në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

II. Prokurorët nga pika 1 deri në 5 do të avancohen nga data 01 qershor 2018 ndërsa prokurorët nga pika 6 deri në 8 do të avancohen nga data 01 korrik 2018.

III. Për prokurorët e cekur në pikën I të këtij vendimi të hartohen vendime të veçanta dhe të jenë pjesë e dosjes personale të tyre.

IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.

Ani kush po fol gjenerali i nxirrsave



Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.